

KARTA E APOSTOLLIT PAVEL MBE EFESIANETE

Krye 1

¹ Pavli, apostoll i Jisu Krishtit me anë të dashurimit të Perëndisë, mbë shënjtorët që janë ndë Efesë, edhe mbë besëtarët mbë Jisu Krishtinë; ² Hir edhe paqtim **qoftë** mbë ju prej Perëndisë, Atit t'ënë, edhe **prej** Zotit Jisu Krisht.

³ I-bekuarë **qoftë** Perëndia edhe Ati i Zotit t'ënë Jisu Krisht, që na bekoj me çdo bekim shpirti ndë qielloret me anë të Krishtit; ⁴ Sikundrë na sgjodhi neve me anë t'atij përpara se të kriohetë bota, që të jemi shënjtorë edhe faqe-bardhë përpara ati me anë të dashurisë; ⁵ Passi na ndau që përpara për birëri mbë vetëhen' e ti me anë të Jisu Krishtit, pas pëlqimit të dashurimit të ti, ⁶ Për lëvdim të lavdis' së hirit të ti, të-cilinë na dhurëtoj me anë të të-Dashurit **të ti**; ⁷ Tek i-cili kemi çpërblimnë me anë të gjakut t'ati, ndjesën' e fajevet, pas pasjes' së hirit t'ati, ⁸ Të-cilinë e tepëroj mbë ne me çdo dituri e urtësi, ⁹ Dyke bërë neve të njohëmë fshehësirën' e dashurimit të ti pas pëlqimit të ti, që e pat vënë ndër mëntt me vetëhen' e ti, ¹⁰ Që, ndë qiverit të të-mbushurit të kohëravet, të përmbleshnjë të-gjitha mbë Krishtinë, edhe ato **që janë** ndë qiejt edhe ato **që janë** mbi dhet; ¹¹ Mbë atë, mbë të-cilinë edhe muarmë trashëgim, urdhëruarë që përpara sikundrë e pat vënë ndër mëntt ay që vepëron të-gjitha pas ëndës' së dashurimit të ti; ¹² Që të jemi për lëvdim të lavdis' s'ati **neve** që shpëryemë që përpara mbë Krishtinë; ¹³ Mbë të-cilinë **shpëryetë** edhe ju, passi dëgjuatë fjalën' e së-vërtetësë, ungjillin' e shpëtimit t'uaj; edhe mbë të-cilinë passi besuatë uvulostë me Frymën' e-Shënjtëruarë e të-zotuarit, ¹⁴ E-cila është kapari i trashëgimit t'ënë, gjer mbë të-çpërblyerët të lauzit që ufitua për lëvdim të lavdis' s'ati.

¹⁵ Përandaj edhe unë, kur dëgjova besënë t'uaj mbë Zotinë Jisu, edhe dashurinë që kini mbë gjithë shënjtorët, ¹⁶ S'pushonj dyke falurë ndersë Perëndisë për ju, e dyke përmëndurë juve ndë të-falurat të mia, ¹⁷ Që t'u apë juve Perëndia i Zotit t'ënë Jisu Krisht, Ati i lavdisë, frymë diturie e sbulose, që t'a njihni atë; ¹⁸ Që syt' e mëndjesë s'uaj të jenë të-ndriturë, që të njihni cila është shpresa e të-thërriturit t'ati, edhe cila është pasja e lavdis' së trashëgimit t'ati mbë shënjtorët; ¹⁹ Edhe cilëtë është të-matht' e-tepërë të fuqis' s'ati mbë ne që besojmë, pas vepërimit të pushtetit të fuqis' s'ati; ²⁰ Të cilën' e vepëroj mbë Krishtinë, kur e ngjalli atë prej së-vdekurish, edhe e vuri të rrijë mbë të-djathtët të ti mbë qielloret, ²¹ Përsipërë çdo urdhëri e pushteti e fuqie e zotërie e emëri që quhetë jo vetëmë ndë këtë jetë, po edhe ndë atë që vjen; ²² Edhe të-gjitha i vuri ndënë këmbët t'ati, edhe e bëri krye përmbi të-gjitha ndë kishët, ²³ E-cila është trupi i ati, të-mbushurit' e ati që mbush të-gjitha mbë të-gjitha.

Krye 2

¹ Edhe u **dha** jetë juve, që ishitë të-vdekurë për të-shkelurit' e porosivet e për fajetë, ² Mbë të-cilët ectë njëherë, pas jetës' së kësaj bote, pas urdhërtarit të pushtetit të erësë, **që është** fryma që vepëron tani mbë të bijt' e mosbindjesë; ³ Ndër mest të të-cilëvev edhe neve të-gjithë rrojmë njëherë pas dëshërimevet të mishit t'ënë, dyke bërë dashurimet' e mishit edhe të mendimevet **t'anë**; edhe ishimë prej nature djem zëmërate, sikundrë edhe të-tjerëtë. ⁴ Po Perëndia që është i-pasurë ndë përdëllim, për dashurin' e ti të-shumënë me të-cilënë na deshë, ⁵ Ndonëse ishimë të-vdekurë për fajetë, na dha neve jetë bashkë me Krishtinë;

(me hir jeni të-shpëtuarë;)⁶ Edhe na ngjalli bashkë, edhe na vuri të rrimë bashkë ndë qielloret me anë të Jisu Krishtit; ⁷ Që të rrëfenjë ndë jetët që vinjënë pasjen' e-tepërë të hirit të ti me anë të mirësisë **që ka** mbë ne me anë të Jisu Krishtit.

⁸ Sepse me hir jemi të-shpëtuarë me anë të besësë; edhe këjo nuk' **është** prej jush, **po është** dhurata e Perëndisë; ⁹ Jo prej punërash, që të mos mburretë ndonjë.

¹⁰ Sepse jemi kries' e ati, kriuarë mbë Jisu Krishtinë për punëra të-mira, të-cilat' i bëri gati Perëndia që përpara, që të ecëjmë nd'ato.

¹¹ Përandaj sill-e-ni ndër mëntt t'uaj, ju **që ishitë** njëherë gjëndarë pas mishit, që thuheshitë të-parethprerë prej atyreve që thuhenë të-rrethprerë **për një rrethpresje** të-bërë me dorë ndë misht, ¹² Se ishitë nd'atë kohë pa Krisht, të-ndarë veç nga qytetëria e Israilit, edhe të-huaj nga dhjatat' e të-zotuarit, pa pasurë shpresë, edhe të-paperëndishim ndë botët; ¹³ Po ndashti me anë të Jisu Krishtit ju që ishitë njëherë lark uafëruatë me anë të gjakut të Krishtit. ¹⁴ Sepse ay është paqtimi ynë, ay që bëri të dyja një, edhe rrëzoi murin' e-mesm e të-ndarit, ¹⁵ Dyke prishurë armiçësinë ndë trup të ti, **do-me-thënë** nomin' e porosivet që ishinë ndë urdhëra, që të ndërtonjë ndë vetëhet të ti të dy mbë një njeri të-ri, dyke bërë paqtim; ¹⁶ Edhe të dy ndë një trup t'i paqtonjë me Perëndinë me anë të kryqit, passi vrau armiçësinë nd'atë. ¹⁷ Edhe erdhi e lëçiti ungjillin' e paqtimit mbë ju që **ishitë** lark, edhe mb'ata që **ishin'** afërë; ¹⁸ Sepse me anë t'ati kemi të dy të-hyrëtë me një Frymë te Ati.

¹⁹ Përandaj s'jeni më të-huaj e të-përjashtësm, po bashkëqytetës të shënjtorëvet e shtëpiakës të Perëndisë; ²⁰ Sepse undërtuatë mbi themelin' e apostojvet e të profitërket, ku gur çipi është vetë Jisu Krishti; ²¹ Mbë të-cilinë gjithë ndërtesa lidhurë e përmbledhurë bashkë rritetë ndë tempull të-shënjtëruarë mbë Zotinë; ²² Mbë të-cilinë edhe ju jeni ndërtuarë bashkë që të rrijë Perëndia me anë të Frymësë.

Krye 3

¹ Për këtë punë unë Pavli **jam** i-lidhuri i Jisu Krishtit për ju kombetë, ² Sepse dëgjuatë qiverin' e hirit të Perëndisë që m'udha për ju, ³ Se me të-sbuluarë m'a bëri të-njohurë fshehësirënë, (sikundrë u shkrova përpara me pak **fjalë**; ⁴ Prej të-cilavet dyke kënduarë munt të kupëtoni mëndjenë t'ime ndë fshehësirët të Krishtit;)⁵ E-cila ndë të-tjerë breza s'ubë e-njohurë ndë të bijt të njerësvet, sikundrë ndashti usbulua me anë të Frymësë tek apostojt' edhe te profitërit' e ati të-shënjtëruarë; ⁶ Që të jenë kombetë bashkëtrashëgimtarë e një trup e bashkëpjesëtarë ndë të-zotuarët t'ati mbë Krishtinë me anë të ungjillit; ⁷ Të-cilit **un'** i ubëra shërbëtuar pas dhuratës' së hirit të Perëndisë, që m'udha pas vepërimit të fuqis' s'ati. ⁸ Mua më të-vogëlit nga gjithë shënjtorëtë m'udha ky hir të ungjillëzonj ndër kombet të-pavëzhuarshimënë pasje të Krishtit, ⁹ Edhe të ndriçonj të gjithë, **që të dinë**, ç'është të-pasurë pjesë ndë fshehësirët që qe fshehurë që prej jetëvet te Perëndia që krijt të-gjitha (me anë të Jisu Krishtit;)¹⁰ Që të njihetë ndashti ndë urdhëratat e ndë pushtetë ndë qielloret me anë të kishësë e-paanëta dituri' e Perëndisë, ¹¹ Pas qëllimit të-përjetëshëm që bëri mbë Jisu Krishtinë, Zotinë t'ënë; ¹² Me anë të të-cilit kemi kuximnë edhe me besim të-plotë të-hyrëtë me anë të besësë mb'atë. ¹³ Përandaj u lutem juve të mos likshtohi për shtërngimet' e mi që kam për ju, e-cila **gjë** është lavdia juaj.

¹⁴ Përandaj unj gjunjët' e mi përpara Atit të Zotit t'ënë Jisu Krisht, ¹⁵ prej të-cilit quhetë çdo atëri ndë qiejt e mbi dhet, ¹⁶ Që t'u apë juve pas pasjes' së lavdis' së ti, të forçohi ndë fuqi me anë të Frymës' s'ati mbë njerin' e-përbrëndëshëm; ¹⁷ Që të rrijë Krishti ndë zëmërat t'uaj me anë të besësë, ¹⁸ Që të-rrenjosur' e të-themelosurë ndë dashurit të muntni të kupëtoni bashkë me gjithë shënjtorëtë, ç'është të-gjerët' e të-gjatëtë, e të-thellët' e të-lartëtë, ¹⁹ Edhe të njihni dashurin' e Krishtit që kapërxen çdo dituri, që të mbusheni me gjithë të-mbushurit' e Perëndisë.

²⁰ Edhe mb'atë që pas fuqisë që vepëronetë ndër ne munt të bënë shumë më tepërë nga gjithë sa kërkojm' a mendojmë, ²¹ Mb'atë **qoftë** lavdia ndë kishët me anë të Jisu Krishtit mbë gjithë brezat të jetës' së jetëvet. Amin.

Krye 4

¹ U lutem pra juve un' i-lidhuri mbë Zotinë të ecëni sikundrë vëjen mbë të-thirrurit që uthërritë, ² Me çdo mëndje përunjtjeje e butësire, me zëmërë të-gjerë, dyke duruarë njëri tjetërinë me dashuri, ³ Dyke kujdesurë të ruani bashkëimin' e Frymësë me anë të lidhjes' së paqtimit. ⁴ Një trup e një Frymë **ka**, sikundrë edhe uthërritë me një shpresë të të-thërriturit t'uaj; ⁵ Një Zot, një besë, një pagëzim; ⁶ Një Perëndi edhe Atë i të-gjithëve, i-cili është përmbi të-gjithë, edhe me anë të të-gjithëve, edhe ndër gjithë ju.

⁷ Edhe gjithë-sicilit prej nesh i udha hiri pas masës' së dhurëtis' së Krishtit. ⁸ Përandaj thotë, "Si hipi lart, skllavosi skllavëri, edhe u dha dhurata njerësvet." ⁹ Edhe se, "ay hipi," **ç'tjetërë** është, veç se edhe sbriti më përpara ndë më të-poshtërat anë të dheut? ¹⁰ Ay që sbriti, është' ay që edhe hipi përsipërë gjithë qiejvet, që të mbushnjë të-gjitha. ¹¹ Edhe ay dha ca **të jenë** apostoj, e ca profitër, e ca ungjillëzorë, e ca barinj e mësonjës, ¹² Për ndreqjen' e shënjtorëvet, për punën' e shërbesësë, për ndërtesën' e trupit të Krishtit; ¹³ Gjersa të arrijmë të-gjithë ndë bashkimit të besësë, edhe të të-njohurit të Birit të Perëndisë, ndë burrë të-mbaruarë, ndë masët të moshës' së të-mbushurit të Krishtit; ¹⁴ Që të mos jemi më foshnje, që trumbullonenë e që sillenë këtu e atje prej çdo ere të mësimi, prej gënje-shtrës' së njerësvet, e prej dinakërisë për të kobuarë mjeshtëri; ¹⁵ Po dyke folurë të-vërtetëne me dashuri të rritimi së-gjithash mb'atë, i-cili është kryetë, Krsihti; ¹⁶ Prej të-cilit tërë trupi i-përmbledhurë bashkë e i-lidhurë bashkë me anë të bashkimit të çdo ndihme, që ep me masë sicilado anë, sipas vepërimit të-duheshim që ka, bën të-thërriturit' e trupit, për të-ndërtuarët' e vetëhes' së ti me dashuri.

¹⁷ Them pra këtë, edhe dëshmonj mbë Zotinë, të mos ecëni më, sikundrë ecënjënë edhe kombet' e-tjerë ndë kotësirët të mëndjes' së tyre, ¹⁸ Dyke qënë të-errësuarë nga mëndja, e të-larguarë nga jeta e Perëndisë, për paditjenë që është ndër ata, për ashpërimin' e zëmërës' së tyre; ¹⁹ Të-cilëtë pa ndërë dhëmbje dhanë vetëhen' e tyre ndë fëlliqëri, që të punonjë çdo ndyrësi me lakmim. ²⁰ Po ju nuk' e keni nxënë kështu Krishtinë, ²¹ Ndë qoftë se e keni dëgjuar' atë edhe jeni mësuarë mb'atë, sikundrë **është** e-vërteta mbë Jisunë; ²² Të svishni njerin' e-vjetërë **që është** pas të-rrojturitë që **rronitë** më përpara, i-cili prishetë pas dëshërimevet të kobimit; ²³ Edhe të përtërihi ndë frymët të mëndjesë s'uaj, ²⁴ E të vishni njerin' e-ri, që është ndërtuarë pas Perëndisë me drejtëri e me shenjtëri të së-vërtetësë.

²⁵ Përandaj, dyke hedhurë tej gënjeshtërë, "flisni të-vërtetëne sicili me të-afërmin' e ti." Sepse jemi anë të njëri tjetërit. ²⁶ -"Zëmërohi e mos fëjeni;" djelli letë mos perëndonjë mbë zëmërimt t'uaj; ²⁷ As mos i bëni vënt djallit. - ²⁸ Ay që vjeth, letë mos vjedhë më, po më tepërë letë mundonetë dyke punuarë të-mirënë me duart' e **tia**, që të ketë t'i apë ati që ka nevojë. ²⁹ -Çdo fjal' e-kalburë letë mos dalë prej gojës' s'uaj, po ajo që është e-mirë për ndërtesën' e nevojësë, që t'u apë hir atyre që dëgjonjëne.

³⁰ Edhe mos hidhëroni Frymën' e-Shënjtëruarë të Perëndisë, me të-cilën' uvulostë për ditën' e çpërblimit.

³¹ Çdo pikëllim e mëri e zëmëratë e të-bërtiturë e të-sharë, letë hiqetë **lark** prej jush bashkë me çdo ligësi; ³² Edhe bëhi njëri mbë tjetërinë të-mirë, zëmërë-dhëmburë, dyke ndërë njëri tjetërinë, sikundrë edhe Perëndia u ndjeu juve me anë të Krishtit.

Krye 5

¹ Bëhi pra shëmbëllimtarë të Perëndisë, si djem të-dashurë; ² Edhe ecëni me dashuri, sikundrë edhe Krishti na deshi, edhe e dha vetëhen' e ti për ne dhuratë e kurban te Perëndia, për erë të-mirë.

³ Po kurvëri e çdo ndyrësi, a lakmim, as të-zihetë n'gojë ndër ju, sikundrë u ka hijë shënjto-rëvet; ⁴ As turpëri e fjalë të-marrë a fjalë për të përqeshurë, të-cilatë s'kanë hije; po më tepërë të-falurë ndersë. ⁵ Sepse këtë e dini, se çdo kurvar, a ndyrës, a lakmimtar, i-cili është idhullatër, s'ka trashëgim ndë mbretërit të Krishtit e të Perëndisë. ⁶ Asnjëri letë mos u kobonjë juve me fjalë të-kota; sepse për këto **punë** vjen zëmërat' e Perëndisë mbi bijt' e pabindjesë. ⁷ Mos ubëni pjesëtarë bashkë me ata. ⁸ Sepse njëherë ishit' errësirë, po ndashti **jeni** dritë mbë Zotinë; ⁹ Ecëni si djem të dritësë, (Sepse pem' e Frymësë është mbë çdo mirësi, e drejtëri, e të-vërtetë;) ¹⁰ Dyke provuarë ç'**gjë** është e-pëlqyerë te Zoti; ¹¹ Edhe mos shoqëroni ndë punërat të-papemshime të errësirësë, po më tepërë t'i qërtoni. ¹² Sepse ato që punonën fshëhuraj nga ata, është turp edhe t'i thotë **njeriu**. ¹³ Po gjithë sa qërtonenë prej dritësë, çfaqenë; sepse çdo gjë që çfaqetë është dritë. ¹⁴ Përandaj thotë, Ngreu ti që fle, edhe ngjallu prej së-vdekurish, edhe Krishti dotë të ndriçonjë.

¹⁵ Shikoni pra qysh të ecëni me kujdes; jo si të-marrë, po si të-urtë, ¹⁶ Dyke çpërblyerë kohënë, sepse dittë janë të-këqia. ¹⁷ Përandaj mos bëhi të-çmëndurë, po **asish** që kupëtonjënë ç'është dashurimi i Zotit. ¹⁸ Edhe mos dehi me verë, ndë të-cilët ka plankrishje; po mbushuni me Frymë të-Shënjtëruarë, ¹⁹ Dyke folurë ndë mest t'uaj me psallma e me kënkë shpirtërishte, dyke kënduar' e dyke psallurë Zotit me zëmërenë t'uaj; ²⁰ Dyke i falurë ndersë Perëndisë edhe Atit mb'emërit të Zotit t'ënë Jisu Krisht përherë për të-gjitha; ²¹ **Edhe** dyke unjurë kryetë njëri tjetërit me frikë Perëndie.

²² Ju gratë, binduni burravet t'uaj, posi Zoti; ²³ Sepse burri është kryet' e gruasë, sikundrë edhe Krishti **është** kryet' e kishësë, edhe ay është shpëtimtari i trupit. ²⁴ Po sikundrë kisha i bindetë Krishtit, kështu edhe gratë **let' u bindenë** burravet të tyre së-gjithash.

²⁵ Ju burratë, doni gratë t'uaj, sikundrë edhe Krishti deshi kishënë, edhe dha vetëhen' e ti për atë, ²⁶ Që t'a shënjtëronjë, dyke pastruarë atë me të-larët' e ujit, me anë të fjalësë; ²⁷ Që t'a nxjerrë atë përpara vetëhes' së ti kishë të-lavduruarshime, që s'ka këllirë, a rurdhë, a ndonjë nga të-këtillatë, po që të jet' e-shënjtëruarë e pa të-metë. ²⁸ Kështu kanë detyrë burratë të duanë grat' e tyre, posi trupërat' e tyre. Ay që do gruan' e ti, do vetëhen' e ti; ²⁹ Sepse asndonjë ndonjëherë s'e pati çmir mishin' e ti, po e ushqen edhe e ngroh, sikundrë edhe Zoti kishënë. ³⁰ Sepse jemi anë të trupit t'ati, prej mishit t'ati edhe prej eshtëravet t'ati. ³¹ "Përandaj njeriu dotë lerë t'an' e t'ëmënë edhe dotë ngjitetë pas gruas' së ti, edhe dotë jenë të dy një mish." ³² Këjo fshehësirë është e-madhe; po unë e them **këtë** për Krishtin' e për kishënë.

³³ Po edhe ju veç e veç, gjithë-sicili kështu let'a dojë gruan' e ti, posi vetëhen' e ti; edhe gruaja let' i ketë frikë burrit.

Krye 6

¹ Ju djemtë, binduni prindërvet t'uaj mbë Zotinë; Sepse këjo është e-drejtë. ² "Ndero t'ët atë e t'ët ëmë," (e-cila është porosi e-parë me të-zotuarë,) ³ "Që të të bënetë mirë ty, e të jesh jetë-gjatë mbi dhet."

⁴ Edhe ju atëritë, mos zëmëroni djemtë t'uaj, po i arrëseni ata me mësim e me këshillë të Zotit.

⁵ Ju shërbëtorëtë, binduni zotërinjvet t' uaj pas mishit me frikë e me të-dridhurë, me kthjellësirë të zëmëresë s' uaj, posi Krishtit; ⁶ Jo si shërbëtorë për faqe, si asish që **duanë t' u** pëlqenjënë njerëzet, po si shërbëtorë të Krishtit, dyke bërë dashurimn' e Perëndisë prej shpirti, ⁷ **Si** dyke punuarë me zëmërë të-mirë Zotit, e jo njerësvet; ⁸ Sepse e dini, se çdo të-mirë që të bënë gjithë-sicili, këtë edhe dotë marrë prej Zotit, a shërbëtuar **qoftë**, a i-lirë.

⁹ Edhe ju zotërinjtë, gjithato bëni tek ata, dyke lënë të-frikësuarëtë; sepse e dini, se edhe ju vetë keni Zot ndë qiejt, edhe tek ay s' ka të-mbajtur' anë.

¹⁰ Pra, o vëllezërit' e mi, forcohi mbë Zotinë edhe ndë pushtett të fuqis' s' ati; ¹¹ Vishni gjith' armët' e Perëndisë, që të muntni t' u qëndroni kundrë mjeshtërivet të djallit; ¹² Sepse lufta jonë nuk' është kundrë gjaku e mishi, po kundrë urdhëratavet, kundrë pushtetevet, kundrë mbretërvet t' errësirës' së kësaj jete, kundrë frymavet të-liga ndë qielloret. ¹³ Përandaj merrni me vetëhe gjith' armët' e Perëndisë, që të munt-ni të qëndroni kundrë ndë ditët të-keqe, edhe si të keni bërë gati të-gjitha, të qëndroni **mbë këmbë**. ¹⁴ Qëndroni **mbë këmbë** pra ngjeshurë mezinë t' uaj me të-vërtetë, edhe veshurë thurakun' e drejtërisë, ¹⁵ Edhe mbathurë këmbëtë me të-qënuritë gati për ungjillin' e paqtimit. ¹⁶ Edhe përmbi të-gjitha, merrni me vetëhe mburonjën' e besësë, me të-cilënë dotë muntni të shuani gjithë shëgjetat' e-ndezura e të-ligut; ¹⁷ Edhe merrni përkrenoren' e shpëtimit, edhe thikën' e Frymësë, që është fjala e Perëndisë; ¹⁸ Dyke falurë ndë Frymë mbë çdo kohë me çdo farë të-faluri e të-luturi, edhe mbë gjithë këtë dyke ndënjurë sgjuarë me çdo farë durimi e të-luturi për gjithë shënjtorëtë. ¹⁹ Edhe për mua, që të më epetë fjalë të hap gojë të ime me kuxim, që t' a bënë të-njohurë fshehësirën' e ungjillit, ²⁰ Për të-cilinë **unë** jam lajmës ndë vark **hekurash**, që të flas për atë me kuxim, sikundrë gjan të flas.

²¹ Po që të dini edhe ju të-miatë, ç' bënë, të-gjitha dot' ua rrëfenjë juve Tiqiku, vëllaj i-dashurë edhe shërbëtuar besëtar mbë Zotinë; ²² Të-cilinë e dërgova ndër ju për këtë punë, që të mësoni punëratë t' ona, edhe që të ngushullonjë zëmëratë t' uaj.

²³ Paqtim **qoftë** mbë vëllezëritë, edhe dashuri me besë nga Perëndia, Ati, edhe nga Zoti Jisu Krisht. ²⁴ Hir **qoftë** bashkë me gjith' ata që duanë Zotinë t' enë Jisu Krisht me zëmërë të-kthjellëtë. Amin.